

VENDIM
Nr. 634, datë 10.10.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1178, DATË 24.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE
RREGULLAVE TË HOLLËSISHME TË EVIDENTIMIT TË NDËRTIMEVE PA
LEJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, pika 6, dhe 69, pika 9, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 20, e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Për kryerjen e procedurave të përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi, Agjencia Shtetërore e Kadastrës mund të veprojë nëpërmjet stafit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në kuadër të një marrëveshjeje të nënshkruar sipas ligjit ose mund të kontraktojë subjekte private të licencuara në fushat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.”.

2. Aneksi 1 “Akt evidentimi”, ndryshohet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe të gjitha bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREKTORIA []

AKT EVIDENTIMI
Nr. [], datë []

PËR GJENDJEN NDËRTIMORE NË TERREN, TË NDËRTIMIT PA LEJE

Në zbatim të nenit 17, pika 3 dhe 69, pika 9, të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.... "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje" u krye evidentimi në terren i ndërtimit pa leje i llojit, ☐ Objekt, ☐ Shtesë, ☐ Objekt me shkelje të lejes së ndërtimit përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit Nr. [] prot., datë [] me Numër Unik (INDEX): me adresë _____

Nga evidentimi në terren rezulton se ndërtimi pa leje posedohet nga:

1.
Nr.identifikimi (ID): _____, Nr.cel: _____, Adresa: _____
(Emër Afësi Mbiemër)

Ndërtimi pa leje me funksion _____ **ka këto të dhëna ndërtimore:**
-Sipërfaqja e bazës (njollës) së objektit _____ m²
-Numri i kateve mbi tokë _____ dhe nën tokë _____
-Sipërfaqja e përgjithshme e ndarë sipas funksionit: _____ banim (Sip.m²), aktivitet social-ekonomik _____ (Sip.m²)
-Sipërfaqja e parcelës ndërtimore _____ m² me objekt ndihmës ☐ pa objekt ndihmës ☐

*E aplikueshme vetëm për shtesën, objektin me shkelje të lejes së ndërtimit:

-Aplikuesi për legalizim është shoqëri ndërtuese dhe/ose investitor ☐
-Shtesa është kryer për qëllim kalimi pronësie ose qiradhënie ☐
-Funksioni i hapësirave sipas faktit: _____
(Sip.m² për secilin funksion): _____

-Funksioni i hapësirave sipas projektit të miratuar _____
(Sip.m² për secilin funksion) _____

Pasuritë kufitare (nr.pasurisë, emër, mbiemër i pronarit të objektit kufitar, lloji i pasurisë psh.objekt, rrugë/kanal etj):

Në veri: _____
Në jug: _____
Në perëndim: _____
Në lindje: _____

Evidentimi në terren u krye nga:

Specialisti i ASHK/Përfaqësuesi i subjektit/ Përfaqësuesi i bashkisë:

1. _____ 2. _____ 3. _____
(emër, mbiemër, firmë) (emër, mbiemër, firmë) (emër, mbiemër, firmë)

Konfirmoi për strukturën e Hartografikë të ASHK-Përgjegjësi _____
(emër, mbiemër, firmë)

1-Ky akt plotësohet elektronikisht dhe pas nënshkrimit ruhet në 2 kopje, respektivisht një administrohet në praktikën e legalizimit dhe tjetra ruhet në përputhje me legjislacionin për arkivat.

2-Kopja e Aktit të evidentimit shoqërohet detyrësisht me skicë tushore.

3-Sipërfaqet që evidentohen në akt do të plotësohen me shifra dhe fjalë.

4-Verifikimi në terren kryhet nga jo më pak se dy specialistë të ASHK, punonjësi i Bashkisë ose punonjësi të subjektit të kontraktuar.